



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4567 Prot.

Lezhë, më 14.04.2020

V E N D I M

Nr 46, Datë 10 / 04 /2020

Për miratim projekti dhe një ndryshimi në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.125, datë 26.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020, dhe të PBA-së 2020-2022”

Në mbështetje të nenin 54 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1.Miratimin e projektit “Krijo dhe Interpretu në shtëpi” dhe të një ndryshimi në vendimin e këshillit bashkiak nr.125, datë 26.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”, konkretisht bëhen këto ndryshime në programin buxhetor “09120 “Arsim bazë dhe parashkollor”, si më poshtë;

1/a. Pakësohet projekti me emërtim “Pagesë për 10 mësues të jashtëm” për shumën 320,000 lekë.

1/b.Shtohet projekti me emërtim “Krijo dhe interpret në shtëpi” për shumën 320,000 lekë.

Veprimet të kryhen brenda programit – Kodi 09120, Kap.05, Art/ llog.ek.602 për shumën 320,000 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

